

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Keshilli i Ministrave

URDHER

Nr.168, date 28.10. 2005

PER NGRITJEN E GRUPIT TE PUNES PER PARANDALIMIN DHE MARRJEN E MASAVE MBROJTJES NDAJ SEMUNDJES SE GRIPIT TE SHPENDEVE (INFLUENCA AVIARE)

Ne mbështetje te pikes 3, te nenit 102, te Kushtetutes, dhe te pikes 1, te nenit 12, te ligjit nr.9000, date 30.1.2003, "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit te Ministrave",

URDHEROJ:

1. Ngritjen e grupit te punes, per parandalimin dhe marrjen e masave mbrojtese ndaj semundjes se gripit te shpendeve (Influenca aviare), i cili te mblidhet brenda 3 diteve nga hyrja ne fuqi te ketij urdhri.

2. Grupi i punes te kryesohet nga zevendesministri i Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit e ne perberje te kete anetare: .

Zevendesministrin e Shendetesise; .

Drejtorin e Drejtorise se Kujdesit Paresor, ne Ministrine e Shendetesise;

. Drejtorin e Drejtorise se Veterinarise, ne Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit;

. Pergjegjesin e sektorit te shendetit te kafsheve, ne Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit;

. Pergjegjesin e sektorit te shendetit publik veterinar, ne Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit; .

Drejtorin e Institutit te Kerkimeve Veterinare; .

Pergjegjesin e departamentit te virologjise, ne Institutin e Kerkimeve Veterinare; .

Drejtorin e Institutit te Shendetit Publik; .

Pergjegjesin e departamentit te lendeve paraklinike (Virolog), ne fakultetin e Mjekesise Veterinare, ne Universitetin Bujqesor, Kamez;

. Nje perfaqesues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve;

. Nje perfaqesues nga Ministria e Brendshme;

. Nje perfaqesues nga Ministria e Financave;

. Nje perfaqesues nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave;

3. Grupi i punes ka per detyre:

Te hartoje dhe zbatoje programin e masave per kontrollin dhe mbrojtjen nga semundja e gripit te shpendeve;

T'u propozojte, ne situata emergjente, organeve shteterore pergjegjese marrjen e masave perkatese, ne perputhje me ligjin, te detyrueshme edhe per personat, fizike e juridike, private.

4. Efektet financiare te perballohen nga buxhetet e ministrive dhe te institucioneve, te permendura ne piken 2, te ketij urdhri. Ne rast pamjaftueshmerie te propozohet perdorimi i fondit rezerve te Keshillit te Ministrave.

5. Ngarkohen ministrat perkates dhe drejtuesit e institucioneve te permendura ne piken 2, me siper, per zbatimin e ketij urdhri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA